

Bashkim Selmani, PhD<sup>1</sup>

UDC:

32-048.76(100-15)-022.56

**POLITIKAT KRAHASUESE DHE KONCEPTI LOGJIK I  
ZBATIMIT POLITIK  
DHE SFIDAT E SUKSESIT OSE DËSHTIMIT**

**КОМПАРАТИВНИ ПОЛИТИКИ И ЛОГИЧКИОТ КОНЦЕПТ  
НА ПОЛИТИЧКАТА ИМПЛЕМЕНТАЦИЈА И  
ПРЕДИЗВИЦИТЕ НА УСПЕХОД ИЛИ НЕУСПЕХОТ**

**COMPARATIVE POLICIES AND CONCEPTUAL LOGIC OF  
POLITICAL IMPLEMENTATION  
AND CHALLENGES OF SUCCESS OR FAILURE**

A national state can be judged by the treatment they have for their own intellect and in case the intellect does not appreciate they are enemies of themselves.

**Abstract**

The purpose of political analysis is essentially descriptive. The scientific method is inadequate for the study of human behavior. The purpose of the political analysis is explanatory. The structure of scientific explanation applies to the study of politics with some modifications. It focuses attention on the constitutionally defined structures in the major Western powers. It is focused on contextual factors that weaken the boundaries between political science and other social sciences. It

---

<sup>1</sup> Bashkim Selmani, PhD Lecturer at the State University of Tetova, Faculty of Law and exercises the post of Chief of Political Science.

depicts country-by-country analysis. It presents the material in a thematic way, generalizing beyond the national and cultural boundaries. It relies on the impression of political phenomena. Requires collecting sensitive data to test proposals that may be denied by this type of data. Researchers who have taken the first position emphasize the process of generalization beyond the national and cultural boundaries, the process of being comparative. They are less interested in the nations given as such and more on how patterns of political phenomena appear in different nations. Researchers embracing the second position have more interest in investigating the organization of factors within a nation. Stressing the peculiarities of each of these organizations, and stressing that understanding of any social or political phenomenon is affected by the national system in which it emerges, this group of researchers in fact denies the practical possibility of generalization of such phenomena beyond national boundaries. One cannot generalize in terms of parties organized on a professional basis, for example, because the nature itself of each of these parties is the product of the specific organization of the historical, geographical, cultural and technological factors that make up the context in which each one appears.

**Key words:** politics, political analysis, comparative politics, political logic, goal, political method, the process of being comparative, Albanian politics, priority, failures, etc.

### **1. Pushteti nuk është asgjë, po nuk e ktheve në influencë.<sup>2</sup>**

Duke prezentuar idetë kryesore të zhvillimit politikë dhe tendenca e transformimit për një zhvillim të suksesshëm botëror, shkenca dhe hulumtimet shkencore na japin një panoramë të evolucionit të marrëdhënieve ndërmjet të gjithë aktorëve transnacionalë, për zhvillimet historike që kanë ndikuar në zhvillimin politikë ndërmjet aktorëve botëror dhe superfuqive të mëdha që përbëjnë edhe tani prirjet globale më të rëndësishme që ky ndërveprim prodhon në organizimin e shoqërisë bashkëkohore.<sup>3</sup> Teoritë më të mëdha që përdoren nga studiuesit në

---

<sup>2</sup> Condoleeza Rice, ish-Sekretare e SHBA-së.

<sup>3</sup> Historia e Zhvillimit të Shkencave Politike-Fillon me studimin sistematik të politikës në Greqinë dhe Romën e Lashtë (2500 vjet PES) dhe vazhdon në aspektin tradicional deri në vitet 1950 kur shkolla “tradicionale” filloi të humbë shkëlqimin e saj dhe triumfi i developmentalizmit (zhvillimizimit) u bë i qartë.

shpjegimin e dinamikave të marrëdhënieve ndërkombëtare konsiderojnë si qasje themelore krahasimin, realizimin dhe konstruktivizmin në modelimin e hulumtimit të politikëbërjes së suksesshme ndërkombëtare. Kjo edukon të menduarit kritik duke i kërkuar studentëve në mënyrë të përsëritur që të vlerësojnë mundësitë e së ardhmes së politikës gjithëshqiptare dhe të impaktit të saj të mundshëm mbi vetë jetën e tyre në fushëbetejën e politikës globale. Siç edhe e theksuam më lartë, duke ditur se përpjekja shkencore sjell një nivel të lartë të legjimitetit, të paktën në shkencat ekzakte, në vitet 1950-të shumë shkencëtarë politikë, së bashku me shkencëtarë të tjerë socialë, ndërmorën një përpjekje për të transformuar fushën e tyre në një të atillë që do të gëzonte të mirat e shumta të respektimit shkencor. Politika krahasuese, deri atëherë konsideruar gjithmonë si nënfushë e shkencës politike, luajti një rol udhëheqës në këtë përpjekje. Duke vepruar kështu, shumë prej studiuesve në krye të politikës krahasuese u përpoqën të transformonin rrënjësisht nënfushën e tyre në një pjesë integrale të shkencës politike “shkencore”. Kjo përpjekje pati vetëm sukses të moderuar dhe e la fushën e politikës krahasuese të përçarë dhe pa një sens të pranueshëm nga të gjithë përsa i takonte identitetit të saj.<sup>4</sup>

Për të trajtuar dhe njohur fazat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi shkencor në fushën e politikave krahasuese, fillimisht duhet ditur se përpjekja shkencore sjell një nivel të lartë të legjimitetit, të paktën në shkencat ekzakte. Megjithëse struktura e çdo shpjegimi shkencërisht të respektueshëm është e njëjtë nga subjekti, pikërisht në këtë rast dukuria duhet të shpjegohet dhe të tregohet se si një rast politikë apo i veçantë i një pohimi të përgjithshëm i marrëdhënies midis koncepteve apo kategorive të dukurive përcillet dhe sqarohet nëpërmjet metodave hulumtuese që kanë një ndikim të fuqishëm për ardhjen deri tek e qëllimi që kemi përcaktuar për një çështje hulumtuese politike apo shoqërore. Qëllimi i analizës politike është në thelb përshkrues. Metoda shkencore është e papërshtatshme për studimin e sjelljes njerëzore.

## 2. Qëllimi i analizës politike është shpjegues

Struktura e shpjegimit shkencor aplikohet në studimin e politikës me disa modifikime. E fokuson vëmendjen në strukturat e përcaktuara

<sup>4</sup> Mosmarrëveshja themelore në politikën krahasuese: fusha duhet përkufizuar nga qëllimi i saj të bëjë shkencën politike të respektueshme nga ana shkencore ose nga subjekti i saj kombet përveç SHBA-së.

kushtetueshmërisht në fuqitë kryesore perëndimore. Është e fokusuar në faktorët kontekstualë që dobësojnë kufijtë mes shkencës politike dhe shkencave të tjera shoqërore. E paraqet analizën të bazuar vend për vend. E paraqet materialin në mënyrë tematike, duke përgjithësuar përtej kufijve kombëtarë dhe kulturorë. Mbështetet në kuptimin përshtypjelënës të fenomeneve politike. Kërkon të mbledhë të dhëna të ndjeshme për të testuar propozimet që mund të përgënjeshtrohen nga këto lloj të dhënash.

Studiuesit që kanë ndërmarrë pozicionin e parë theksojnë procesin e përgjithësimit përtej kufijve kombëtarë dhe kulturorë, procesin e të qenit krahasues. Ata janë më pak të interesuar në kombe të dhëna si të tilla dhe më shumë në atë se si modele të fenomeneve politike shfaqen nëpër kombe të ndryshme. Studiuesit që përqafojnë pozicionin e dytë kanë më tepër interes në hetimin e organizimit të faktorëve brenda një kombi. Duke theksuar veçantinë e secilit prej këtyre organizimeve, dhe duke theksuar se të kuptuarit e çfarëdolloj fenomeni shoqëror apo politik ndikohet nga sistemi kombëtar në të cilin shfaqet, ky grup studiuesish në të vërtetë mohon mundësinë praktike të përgjithësimit rreth fenomeneve të tilla përtej kufijve kombëtarë. Dikush nuk mund të përgjithësojë sa i takon partive të organizuara në bazë të profesionit, për shembull, sepse vetë natyra e secilës prej këtyre partive është produkt i organizimit specifik të faktorëve historikë, gjeografikë, kulturorë dhe teknologjikë që përbëjnë kontekstin në të cilin secila shfaqet. Pozicioni i këtyre studiuesve është që kombet duhet studiuar një e nga një si një organizim i veçantë në formë unike i fenomeneve të politikëbërjes bashkëkohore.<sup>5</sup> Ata studiues që kërkojnë të transformojnë fushën në një me respekt shkencor të rritur theksojnë përpjekjen e përgjithësimit përtej kufijve kombëtarë dhe kulturorë si thelbin e asaj që politika krahasuese ka për të kontribuar për shkencën politike. Për ta, arsyeja e ekzistencës së politikës krahasuese gjendet në rolin e saj të zhvillimit të shpjegimeve të qëndrueshme përtej kombit për fenomenet politike.

Grupi i dytë thekson përshkrimin në thellësi dhe të kuptuarit impresionist të kombeve të ndryshme duke i marrë një e nga një në konsideratë. Ky grup hedh poshtë qëllimin shpjegues të politikës krahasuese si të përealizueshëm tani për tani. Për më tepër, ky grup argumenton se studentët e politikës krahasuese kanë aq pak njohuri themelore

<sup>5</sup> *Të lashtët* Testamenti i vjetër në Bibël, krahason popullin dhe Sovranët e Izraelit me atë të popujve të tjerë: Egjiptin, Babiloninë, Persinë, Kanaanitët, etj, Njerëzit e Zotit duhet të zbatojnë mësimet e tij në jetën politike dhe shoqërore, fillimi i moralit politik.

sa i takon strukturave dhe proceseve të qeverive të huaja sa që çdo përpjekje për të folur teorikisht për modelet qeveritare në këto vende do të ishte i pakuptimtë.<sup>6</sup> Dikush duhet të dijë fillimisht se si funksionojnë këto qeveri të ndryshme, përpara se të përgjithësojë për to. Kështu, edhe nëse zhvillimi i teorisë shpjeguese përtej kombit është i realizueshëm, marrja e informacionit për vendet e tjera duhet t'i paraprijë këtij qëllimi mendjemadh në nivelin universitar.

Përkufizimi i politikës krahasuese është ndërtimi i përgjithësimave të atilla që të aplikohen përtej kufijve të një vendi të caktuar përgjithësimave tejevndore. Kur këto përgjithësime përkapin logjikisht fakte ose ngjarje, atëherë këto fakte ose ngjarje "shpjegohen". Studimet që dalin nga vendet e vetme ose rajone të caktuara gjeografike mund të bëhen pjesë e ndërmarrjes së analizës së politikës krahasuese nëse ato inkuadrohen në terma të tillë teorikë që i bëjnë gjetjet e tyre potencialisht të aplikueshme në sisteme kulturore apo kombëtare të tjera dhe të ndryshme. Duke kërkuar të mbështesim qëllimin shpjegues më tepër se sa atë përshkruar të shkencës politike, për të cilin ajo është lavdëruar në erën e pas Luftës së Dytë Botërore, politika krahasuese është bërë e vetmja nënfushë e shkencës politike që përkufizon vetveten më tepër metodologjikisht se sa nga lënda e subjektit që ka nën studim. Mbështetësit e kësaj pikëpamje argumentojnë se analiza e politikës krahasuese është një metodë, e cila luan një rol të paçmuar në ndërmarrjen për të ndërtuar një teori shpjeguese të respektueshme shkencërisht bazuar në fenomenet politike. Është e rëndësishme të kuptohet logjika e këtij argumenti në mënyrë që të kuptohet qëllimi i brendshëm i gjithë zhvillimeve në politikën krahasuese.

### **3. Përpjekjet e përgjithshme për të prezantuar sfidat politike**

Përpjekjet e përgjithshme për të precizuar terminologjinë politike dhe studimin e krahasueshmërisë të politikave globale bëjnë që të ndeshen disa nga idetë për një prosperitet pozitiv të shoqërisë bashkëkohore të globit. Shpeshherë në jetën e përditshme apo përkufizimin e nocionit të politikës apo përkufizimit të fjalorëve që përcaktojnë një term të errët me terma të tjerë jo më pak të errët p.sh.; mundësia për

---

<sup>6</sup> Spartanët, Lykurgisi. Në veprën e Plutarkut Jetët e Grekëve dhe Romakëve me Fam Udhëtoi dhe studioi nëpër Mesdhe duke bërë krahasime të regjimeve politike arkitekti kryesor i sistemit Spartan.

çrënjosjen e instinktit për pushtet është një aspiratë e pashpresë utopike. Shpeshherë politika ndërkombëtare është siç e konsideronte edhe Thomas Hobbes “një luftë për pushtet”, “një luftë e të gjithëve kundër të gjithëve”.

Mirëpo duke qenë se, në anarkinë ndërkombëtare, të gjithë aktorët globalë janë të pavarur, ata duhet të mbështeten te vetvetja për të siguruar mirëqenien dhe sigurinë e tyre. Po të vështrojmë këtë pikëpamje shumëdimensionale të rolit të politikës dhe të politikës ndërkombëtare në përgjithësi do të vërejmë se përpjekjet e përgjithshme për karakterizimin e një disipline shkencore siç është politika krahasuese mund të bëhen shumë shpejt dhe me lehtësi të vagëta e të padobishme në rast se nuk është vullneti politik qëllim mirë. Prandaj në të shumtën e rasteve të praktikës së politikave nacionale nuk vërehet lehtë vullneti i mirë apo pozitiv për mbarë njerëzimin duke pasur pengesë kryesore apo primare interesat individuale dhe ato të palexuara partiake apo nacionale me karakteri nacionalist shpeshherë në vendet ballkanike me theks të veçantë tek shtetet sllave për qëndrimin politikë ndaj shqiptarëve. Shikuar në këtë prizëm politikën krahasuese dhe efektet e mundshme të një fryme realiste demokratike fillimisht duhet të merret parasysh mënyra më e mirë për t’i hyrë brenda një fushe studimi ta ndjekësh politikën në të gjitha hollësitë gjatë studimit dhe të krahasimet me qëllimet e politikave të errëta që më vonë shkaktojnë pasoja për gjeneratat pasardhëse. Në rastin tonë kjo nënkupton studimin e politikave dashakeqe ndaj shqiptarëve në rajon që pikërisht vijnë me metoda më të përsosura që realisht ata veprime ndodhin pikërisht nga armiqtë e shqiptarëve që i realizojnë me miqtë e tyre shqiptarë.<sup>7</sup>

#### 4. Logjika e analizës krahasuese

Është e rëndësishme të kuptojmë logjikën e argumentit dhe të analizës krahasuese, në mënyrë që të kuptojmë qëllimin bazë të asaj çfarë ndodh në politikën e krahasuar në përgjithësi si shkencë politike që realisht mundëson leximin e së vërtetës dhe atë të arsyes së

<sup>7</sup> Prandaj politikës shqiptare i ngelet për të bërë studimin e argumenteve krahasuese për pasojat e këtylla në politikëbërjen shqiptare pa marrë parasysh pozitën gjeografike ku ata jetojnë. (neve dhe gjeneratave pasardhëse na ngelet për të luftuar miqtë e armiqtë tanë që realisht mbajnë peng komoditetin e lirisë shqiptare, duke imponuar në një apo formë tjetër, nepotizimin korrupsionin përzgjedhjen e njerëzve ta pa aftë në vende kyçe, çmoralizimin e dinjitetit nacional etj.)

shëndoshë për një shoqëri bashkëkohore pa kërcënime dhe rreziqe që po i kanosen globit njerëzor. Argumenti i paraqitur këtu është se analiza krahasuese përbën një nga tre metodat që përdoren për të mbikaluar problemin kryesor në formulimin e shpjegimeve shkencore në procesin e kërkimit shkencor social. Argumentimi dhe analiza e cilësive politike përkapën një nga metodat më të rëndësishme të politikës së krahasuar me kombeve. Mosmarrëveshja bazë mes studiuesve të politikës së krahasuar është nëse fusha politike duhet të përcaktohet nga pikësynimi për të bërë shkencën politike shkencërisht të respektueshme nga vet subjektet nacionale dhe ato ndërkombëtare.<sup>8</sup> Faktin që fenomenet shoqërore dhe politike janë produkt i më shumë faktorëve se ç'mund të analizohen në një studim të dhënë. Për shembull, nëse dikush do të donte një shpjegim tërësor të mbizotërimit të dhunës politike në një sistem të veçantë, ky person duhej të gjykonte jo vetëm ndikimin e faktorëve siç mund të jenë të gjitha aspektet e historisë, kulturës, strukturave politike dhe shoqërore, demografisë, si edhe gjeografisë, por edhe atë të sjelljes dhe ndërveprimeve të çdo pjesëmarrësi domethënës në ngjarjet që janë për t'u shpjeguar. Një detyrë e tillë do t'i kalonte caqet e gjithë punës që mund të kryejë çfarëdolloj studiuesi gjatë jetës së tij ose jetës së saj. Kështu, në shkencat shoqërore, vetëm disa prej faktorëve shkaktarë potencialë merren në analizë, dhe të gjitha shpjegimet janë të paplota, ndërsa në shkencat natyrore apo fizike, shpjegimet janë shumë më të plota.

## 5. Struktura e shpjegimit shkencor

Sidoqoftë, struktura e çfarëdo shpjegimi të respektueshëm shkencor është e njëjtë pavarësisht nga subjekti. Fenomeni për t'u shpjeguar paraqitet si një rast i veçantë i përgjithësimit të lidhjes mes koncepteve apo kategorive të fenomeneve. Për shembull, marrim me mend se fakti për t'u shpjeguar është votimi për Partinë Laburiste nga një emigrant indian në Britaninë e Madhe, një person, statusi ekonomik shoqëror i të cilit është dukshëm i klasës së ulët. Dikush mund ta „kuptojë" një votë të tillë si rast të veçantë të premisë se njerëzit e klasës të ulët nga minoritetet e shtypura nga pikëpamje etnike apo e racës kanë tendencën

<sup>8</sup> Grekët, Platoni dhe Aristoteli, koncepti i mbretit filozof, Aristoteli përmbodhi 150 kushtetuta (si UN sot) dhe i studioi ato duke u ndalur edhe në efektet që ato kishin në kulturë, shoqëri dhe ekonomi. Donte me ditë se cila formë e udhëheqjes ishte më e mira dhe më e qëndrueshmja.

e votimit për partitë e majta.<sup>9</sup> Meqë ky individ i takon këtij minoriteti në këtë kontekst, dhe meqë Partial Laburiste është alternativa më praktike e së majtës politike, rasti “shpjegohet” shkencërisht nga kjo premisë e përgjithshme.

Rasti individual mund të jetë rrjedhojë logjike nga premisa e përgjithshme në atë që nëse premisa është e vërtetë, ky rast përbën atë që dikush duhet të konkludojë në mënyrë logjike në të tilla rrethana. Një premisë e tillë shpjeguese nga jep bazën mbi të cilën mund të parashikojmë sjelljen e rasteve të tjera të cilat ende nuk janë vërejtur. Po të marrim të vërtetë premisën e mëparshme, për shembull, do të ishte logjike të mendohej që klasat e ulta hispanike dhe zezake në SHBA do të votonin për Partinë Demokratike. Në tërësi, një premisë si kjo dedukton shkakësim. Deduksioni është procesi mendor i të shkuarit nga diçka që vërehet drejtpërsëdrejti në një konkluzion të interpretueshëm. Deduksioni në këtë rast ka të bëjë diçka me karakteristikat thelbësore të të qenit minoritet i shtypur dhe me të votuarit për një parti të së majtës në atë që karakteristikat e së parës shkaktojnë të dytën. Në këtë rast, ndërtimi i teorisë shpjeguese na lejon të arrijmë në deduksione nga grupi i kufizuar i vëzhgimeve të drejtpërdrejta në një klasë infinite të parashikimeve në rrethana të dhëna.

Aftësia për të parashikuar bazuar në shpjegim është një nga mënyrat e dallimit të shpjegimit që është shkencor nga ai që është sofist apo jo si pasojë e shkakësimit aktual. Një shpjegim që shkakton parashikime të sakta është i testueshëm i provueshëm. Ne e pranojmë si tentativë një shpjegim deri atëherë kur parashikimet e nxjerra logjikisht prej tij janë konform realitetit të vëzhgueshëm. Një premisë apo teori nuk mund ta vërtetojmë sepse, meqë teorinë shkencore i referohen një të ardhmeje të pafundme infinite, ne kurrë nuk arrijmë të shohim të gjitha provat në lidhje me të. Megjithatë ne mund të përcaktojmë kriteret për të mos vërtetuar çfarëdolloj premise apo teorie mbi bazën e mosgjetyes së fenomeneve që pritej të vinin si rrjedhojë logjike nga teoria. Kështu, rrëfimi biblik i krijimit, pa marrë parasysh gjykimet për vërtetësinë absolute të tij, zakonisht nuk konsiderohet shkencor prej studiuesve sepse si një ngjarje që ndodhi vetëm njëherë, nuk ka sjellë rrjedhime logjike për gjetje të ardhshme; për pasojë, në parim nuk është i hapur

<sup>9</sup> Romakët & Ciceroni, argumenti për një formë të përzier të kushtetutës duke shfrytëzuar si tiparet aristokratike ashtu edhe ato qytetare, theksi në ligjin natyral (i gjendshëm në natyrë dhe në renditjen natyrale të sendeve dhe dukurive).



kundrejt përgënjeshtimit. Pra, nuk ka të dhëna të bindshme për ta kundërshtuar apo debatuar këtë rrëfim.<sup>10</sup>

## 6. Mungesa e korrespondimit shkencor me studimin e fenomeneve politike

Mungesa e korrespondimit mes këtij modeli klasik të shpjegimit shkencor dhe çfarë mundësohet në studimin e fenomeneve politike duhet të bjerë në sy menjëherë. Shkenca politike është e zbratur nga premiset e përgjithshme teorike nga të cilat dikush mund të deduktojë ndodhinë e domosdoshme të një ngjarje politike të domethënëse dhe për pasojë edhe komplekse. Arsyeya për këtë, siç u vu re, është se ngjarje apo sjellje të tilla janë produkt i shumë më tepër faktorëve seç mund arsyeshëm të përfshihen brenda çfarëdolloj premise apo studimi. Veprimi, qoftë edhe i një individi të vetëm, është produkt i çfarëdolloj numri dhe kombinimesh të pothuajse një numri dhe shumëllojshmërie të pafundme të përvojave dhe stimulit në jetën e atij personi. Shkaqet e ngjarjeve që janë produkt i ndërveprimit mes shumë individëve rriten spontanisht.

Shikuar në këtë prizëm, mund të themi se çdo premisë rreth shkaqeve të sjelljes ose ngjarjeve politike mund të izolojë vetëm disa nga shkaqet kryesore të këtyre ngjarjeve, që do të mund të quhen të vërteta duke marrë parasysh që të gjithë faktorët domethënës me përjashtim të faktorëve të paanalizuar përjashtojnë njëri tjetrin. Me fjalë të tjera, pretendimet për të vërtetën në shkencën politike janë të vërteta nëse të tjerat janë të barabarta. Kështu, shpjegimi i fenomeneve politike komplekse që mund të ofrojë shkenca politike janë gjithmonë të paplota. Parashikimet që dalin prej shpjegimesh të tilla janë ato që ne i quajmë propabilitike të mundshme. Kjo do të thotë që ato më tepër parashikojnë atë që ndoshta do të ndodhë në rrethana të caktuara me probabilitet domethënës më të lartë se shansi rastësor se sa çfarë duhet doemos të ndodhë në ato rrethana.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Mes thirrjeve më të hershme për transformimin e fushës nga me drejtim tradicional në një me autoritet më shkencor, ndoshta më e famshja është vepra e Roy Macridis, *The Study of Comparative Government* (New York, Random House, 1955). Po ashtu shiko Harry Eskstein "A Perspective on Comparative Politics, Past and Present," në veprën e redaktuar nga Eckstein dhe Apter *Comparative Politics: A Reader* (New York: The Free Press, 1963).

<sup>11</sup> Shih May Brodbeck, "Explanation, Prediction and Imperfect Knowledge," në librin e redaktuar nga May Brodbeck, etj., *Readings in the Philosophy of Social Science*

Struktura thelbësore e shpjegimit mbetet e njëjtë si në modelin klasik, deduktohet parashikimi i fenomenit për t'u shpjeguar nisur nga premisa e përgjithshme. Është pikërisht për sa i takon saktësisë së parashikimeve dhe tërësisë së shpjegimeve që shkencat politike ndryshon nga shkencat natyrore dhe modeli klasik i shpjegimit. Mungesa e tërësisë në shpjegimet tona vjen për shkak të prezencës të lartpërmendur dhe të paevitueshme të faktorëve të paanalizuar që ndikojnë mbi pasojat që duam të shpjegojmë. Rastet studimore shpesh nuk korrespondojnë me parashikimet apo pritshmëritë e dala nga një parim shpjegues për shkak të influencës të variableve të pashpjeguar. Hapi i mëtejshëm është në analizë është gjetja e standardeve apo modeleve në këto raste devijuese dhe izolimi i ndikimit të një apo më shumë variableve të paanalizuar më parë.

Për shembull, dikush mund të zbulojë se ka një lidhje mes arsimimit dhe disa prej qëndrimeve politike, siç mund të jetë predispozita drejt tolerimit të personave me të cilët nuk bie dakord. Po ky kërkues mund të zbulojë se mes njerëzve të arsimuar që kanë një nivel të lartë tolerance, ekziston një grup jotolerant. Ky nëngrup devijues nga grupi i njerëzve të arsimuar mund të ketë një karakteristikë të përbashkët që në fakt mund të jetë shkaktarja e devijimit nga modeli. Atëherë mund të thuhet se arsimimi rezulton në tolerance kur disa orientime fetar e janë prezente por jo në prezencën e orientimeve të tjera. Duke marrë për shembull fenë, kemi dhënë një shpjegim njëkohësisht më kompleks dhe më të saktë.<sup>12</sup>

Dallimi mes shpjegimit në shkencat natyrore dhe në ato shoqërore apo biheviornaliste të sjelljes reflektohet në aftësitë që kanë shpjegimet në klasat përkatëse për të dhënë parashikime. Meqë fenomenet në shkencat natyrore mund të izoloohen nga variable të tjera, parashikimet në këtë fushë mund të bëhen në mënyrë deterministe, vendimtare. Kjo do të thotë që nëse teoria shpjeguese paramendohet të jetë e vërtetë, shkencëtarët mund të thonë në këto kushte se rezultate të caktuara duhet

---

(New York: The Macmillan Co., 1968), f 363., për ekpozenë më të mirë të argumentit që dallimi mes shkencave shoqërore dhe natyrore nuk shtrihet në strukturën e tyre por në tërësinë e tyre dhe në saktësinë e parashikimeve që ato bëjnë.

<sup>12</sup> Karl Popper, *The Logic of Scientific Discovery* (New York: Harper Torchbooks, 1954), f.27, i referohet kësaj paaftësie për të vërtetuar një premisë shkencore në "problemin e induksionit," ideja që dikush nuk mundet që në mënyrë konkluzive të kondukojë se çdo model i vëzhguar do t'i qëndrojë të gjitha kohërave. Për Popperin, "kriteri i demarkimit," ai i cili, dallon një premisë që është shkencore nga ajo që nuk është e tillë është falsibiliteti.

të pasojnë këtë teori. Në shkencat sociale, sidoqoftë, studiuesit mundën vetëm të parashikojnë me një shkallë të njohur probabiliteti të mundësisë së të qenit gabim, duke pasur parasysh vërtetueshmërinë e teorisë së tyre se rezultate të caktuara janë më të pritshme se disa të tjera. Këto lloj parashikimesh shkencore njihem me emrin parashikime probabilitike të *mundshme*.

Forca shpjeguese e teorisë mund të matet me shkallën e rritjes së korrektesisë së parashikimit kundrejt hamendësimeve rastësore. Shpjegimet herë pas herë ofrohen për ngjarje komplekse me qëllim dhënien e përgjigjeve për shkaqet që sollën zhvillimin e ngjarjes.<sup>13</sup> Këto lloj shpjegimesh megjithatë nuk rrisin aftësitë për të parashikuar zhvillime të tjera të pahasura më parë në këtë lloj ngjarje. Për shembull, nazistët në Gjermaninë e Republikës së Vajmarit i shpjeguan problemet ekonomike dhe politike të shoqërisë së tyre në termat e ndikimit të lartë çifut. Megjithatë ai shpjegim nuk mund të rriste aftësitë parashikuese të dikujt për të parashikuar vështirësi të ngjashme në shoqëri të tjera në bazë të përqindjes së çifutëve në popullsinë apo elitën e asaj shoqërie. Ndërsa shpjegimi i dhënë mund të ketë qenë i pranueshëm psikologjikisht për gjermanët duke pasur kështu edhe apel shpjegues njëkohësisht, ky shpjegim nuk kishte fare forcë shpjeguese.

Kështu i kthehemi pohimit të bërë në fillim të këtij seksioni se detyra e përlogaritjes për ndikimin e variableve të paanalizuara më parë është një nga kontributet më thelbësore për qëllimin e përgjithshëm të ndërtimit të një trupe për teorinë shpjeguese në shkencat politike.<sup>14</sup> Tri metoda kërkimore themelore përdoren për të finalizuar këtë përpjekje. Në mbështetje të metodologjisë së kërkimeve shkencore në përgjithësi këto metoda kanë rezultate të njohura në të gjitha shkencat shoqërore, natyrore por edhe në shkencat politike që është temë studimi i lëndës politike krahasuese. Edhe pse më e afërta ndër të trija me modelin e shkencave natyrore, kërkimi eksperimental ngre dyshime serioze sa i takon realizueshmërisë apo praktikitetit në kërkimet politike. Metoda e dytë, dhe ndoshta më e përdorura në shkencën politike moderne, është përdorimi i statistikës, veçanërisht asaj deduktive. Statistika deduktive mund të shihet si në sistem për të parashikuar probabilitetin e gabimit

<sup>13</sup> Ky argument u zhvillua nga Arend Lijphart në artikullin "Comparative Politics and the Comparative Method," në *American Political Science Review*, vol.65, no.3 (September 1971), faqe 682 – 693.

<sup>14</sup> Duhet patur parasysh që origjinali është shkruar për studentët e shkencave politike në SHBA.

kur bëhen deduksione për parametra, karakteristikat apo atributet e popullatës të cilës i referohemi nga atributet e një kampioni popullate të mbajtur nën vëzhgim, apo kur deduktohet shkakësim nga një lidhje e vëzhguar mes dy ose më shumë variableve.

Në shkencat shoqërore, kërkimi pothuajse gjithmonë bazohet në një kampion të një universi infinit, një univers të cilin kërkuesi kurrë nuk e vëzhgon drejtpërsëdrejti. Çdo lloj kampioni, i zgjedhur rastësisht, mund të jetë pak a shumë përfaqësues i universit si tërësi. Nocioni i gabimit të kampionit i referohet realitetit sepse kampioni i marrë do të jetë pak a shumë përfaqësues i të gjithë universit dhe nuk nënkupton gabim. Mes burimeve të gabimit në deduksionet shkakore nga një marrëdhënie statistikore është fakti se kërkuesi është sërish duke punuar nisur nga një kampion dhe prezenca e paevitueshme e variableve të pa-analizuara. Analiza krahasuese mund të shihet si një metodë e tretë për të përlllogaritur për variablet e pa analizuar që e bëjnë përcaktorin “gjërat e tjera të qena të barabarta” pjesë të përhershme të premisave shpjeguese në kërkimin social.

Analiza krahasuese si metodë në këtë sens mund të përkufizohet si ndërtimi i përgjithësimeve shpjegues që janë logjikisht të aplikueshëm në vendvendosje të ndryshme kombëtare dhe kulturore njëkohësisht. Analiza krahasuese bëhet metoda e përshtatshme kur karakteristikat e vetë sistemit politik, dhe jo variablet e varur dhe të pavarur, janë faktorë të pa-analizuar më parë për të cilët dikush kërkon të japë shpjegime. Analiza krahasuese bëhet metoda shpjeguese për përgjithësimet e bëra për sistemet politike dhe shoqërore si njësi tërësore dhe për pasojë duke marrë parasysh atributet e kontekstit në të cilin sjelljet apo ngjarjet politike ndodhin.<sup>15</sup>

Mes këtyre faktorëve kontekstualë janë përvojat historike të një kombi, pozicioni gjeografik, strukturat sociale dhe kultura. Këto janë faktorë për të cilët emri i përveçëm i sistemit mund të përmbajë mbiemra, siç mund të jetë qëndrimi francez kundrejt autoritetit, segmentimi kulturor belg, etj. Mund të parashikohet që të tillë faktorë të kenë ndikim në reagimet e individëve kundrejt stimulit ose përvojës në formë të atillë që një individ në një mjedis të caktuar mund të reagojë ndryshëm kundrejt një përvoje të veçantë në krahasim me një individ në një mjedis tjetër.

---

<sup>15</sup> Kjo metodë përfshin aplikimin e një variabli të pavarur në një grup eksperimental dhe tërheqjen e këtij variabli nga një grup kontrolli),

Analiza krahasuese kërkon të përgjithësojë ndikimin e mjediseve *vendvendosjeve* apo konteksteve në të cilat sjellja dhe ngjarjet politike ndodhin. Për shembull, ndjekja e rregullt e besimit fetar tenton të zhvillojë orientim konservator, dhe, deri tani vonë, gratë kanë pasur tendencën për të qenë më fetare; kështu që gratë kanë qenë më konservative se burrat. Atëherë, do të ishte e mundur të ofronim këtë model shkaku: gjini besim fetar orientim politik. Megjithatë, këto lidhje mund të vërtetohen vetëm në disa prej kombeve. Në mënyrë më specifike, modeli shkaku duket të aplikohet në ato kombe me shkallë të lartë besimi fetar dhe jo në ato laike. Në grupin e dytë të vendeve, në Angli, për shembull, ku vetëm 2.5% e popullsisë ndjek shërbimet fetare të paktën një herë në muaj, dallimi gjinor në besimin fetar zhduket, dhe natyrisht zhduket edhe dallimi gjinor në orientimin politik. Nuk do të ishte e drejtë të thuhej që gratë janë më konservatore se burrat me përjashtim të Anglisë, sepse Anglia, duke qenë një emër i përveçëm, i referohet një subjekti të veçantë. Meqë termi Angli nuk nënkupton ndonjë gjë për ndonjë komb tjetër, shpjegimi nuk ndalon këtu. Sidoqoftë, parimet shpjeguese duhet t'i referohen klasës infinite të rasteve për të aftësuar studiuesin për të ekstrapoluar (argumentuar) nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë në parashikim dhe kështu të shkojë përtej përshkrimit të thjeshtë.

Në shembullin e mëparshëm, atëherë, studiuesi/sja duhet të jetë në gjendje të thotë se çfarë ka Anglia që e bën atë një përjashtim për parimin ose të jetë në gjendje të përgjithësojë rreth faktorëve në kontekstin anglez që e bëjnë sistemin një përjashtim të rregullit të mëparshëm. Në fjalët e Adam Przeworskit dhe Henri Teunes, dikush duhet të përkthejë emrat e përveçëm të sistemeve në variable emrash të përgjithshëm. Në shembullin tonë, kjo do të thotë të përkthehet termi Angli në konceptin e vendeve me shkallë të lartë laicizmi.

Kjo detyrë mund të shihet si një formë tjetër e përkufizimit të thelbit të metodës krahasuese.<sup>16</sup> Në këtë mënyrë, dija ecën aktualisht përpara kur një premisë e vërtetueshme në një kontekst nuk vërtetohet në një tjetër. Kur premisa është e përgënjeshtroshme në një kontekst të veçantë, ndikimi i atij konteksti mund të vlerësohet, matet dhe t'i shtohet teorisë me kompleksitet në rritje. Kështu, metoda krahasuese kërkon të ndërtojë dijen pak nga pak duke shtuar kohën dhe rritur numrin e studimeve.

<sup>16</sup> Mesjeta, Krishtërimi- Saint Augustine dhe Thomas Aquinas i dinin përgjigjet krahasonin vetëm për të rritur efektshmërinë

Mund të shihet nga sa kemi thënë më lart se metoda krahasuese është metoda e përshtatshme kur një përgjithësim duket që pranon vërtetimin në disa vend-vendosje por jo në disa të tjera. Krahasimi në këto raste e aftëson studiuesin/en të formulojë parime që përvijojnë dallimin mes dy klaseve të vendvendosjeve. Megjithatë, është e pamundur të përcaktohet nëse faktorët kontesktualë janë domethënës në vërtetësinë e përgjithësimit nëse më parë nuk aplikohet përgjithësimi në kombe dhe kultura të ndryshme. Kështu analiza politike bëhet në mënyrë të paevitueshme krahasuese, dhe analiza krahasuese e përkufizuar si metodë nuk mund të dallohet nga përpjekja për të ndërtuar shpjegime politike.

### **7. Qartësimi metodave krahasuese**

Kjo qartësohet më tepër kur metoda krahasuese shihet me gjerësisht si procesi i përgjithësimit ndërkontesktual, qofshin këto kohore, hapësinore brenda një kombi, apo kufijtë kombëtarë. Dikush mund të zgjedhë të krahasojë sjelljen brenda të njëjtit komb në kohë të ndryshme, duke i mbajtur kështu faktorët e tjerë përveç atyre që shoqërojnë proceset modernizuese pak a shumë konstante. Dikush tjetër mund të krahasojë rajone të ndryshme brenda një kombi. Kështu, metoda krahasuese është e përshtatshme për të përgjithësuar mes shteteve në SHBA. Në këtë mënyrë dhe duke pasur parasysh se shpjegimi është, siç e kemi parë, në brendësi një veprimtari përgjithësuese, analiza krahasuese mund të jetë sinonimike me studimin shkencor të politikës. Kritikët e metodës krahasuese nuk i adresohen shumë përshtatshmërisë së metodës për studimin shkencor të politikës por janë në përgjithësi skeptikë sa i takon përdorshmërisë potenciale të studimin shkencor të vetë politikës.

Ndërsa metoda krahasuese mund të kuptohet në një sens të gjerë si përgjithësim ndërkontesktual, fusha e politikës krahasuese për qëllimet e këtij teksti përfshin ndërtimin e përgjithësimeve shpjeguese mes ndër dhe mbi nivelet kombëtare sa i takon fenomeneve politike si edhe identifikimit dhe përshkrimit të të dhënave rreth kombeve dhe sistemeve të ndryshme shoqërore që mund të aplikohen kudo dhe në këtë formë mund të kontribuojnë në përpjekjen e parapërmendur të teori ndërtimit.

## 8. Karakteristikat përmbledhëse të metodës krahasuese

Politika krahasuese nuk është shkencë në kuptimin e shkencave ekzakte, teoria komuniste u përpoq ta paraqiste si të tillë. Ajo e ka trupën e rregulluar të njohurive por nuk mund të replikojë eksperimentin laboratorik në jetën e përditshme. Kujdes në përcaktimin e hipotezave dhe planeve kërkimore, në testimin e tyre dhe raportimin e të dhënave. Intervistimi dhe kërkimet në biblioteka nuk janë aq ekzakte dhe edhe nëse përdorim mjete statistikore vetë natyra e metodave i hap ato për interpretime të ndryshme. Qëllimi mbetet një studim i cili është sa preciz ashtu edhe sistematik. Metodatat e reja shkencore si modelimet matematikore, statistikatat, analizat e regresionit na aftësojnë për matje të sofistikuara sasiore që më pare nuk kanë qenë të mundura.

Politika krahasuese prodhon deklarata për tendencat dhe jo prova shkencore. Shikuar në këtë prizëm fjala kyçe në këtë rast tenton të jep kuptimin e analizës politike. Shikuar në këtë prizëm, duhet pasur kujdes kundrejt përdorimit të shkencës për të avancuar njëanshmëritë apo ideologjitë. Qëllimi i politikës krahasuese përkushtohet në shumë anshmëri dimensionale të fushës së studimit të saj, dhe jo në një anshmëri, por, gjithmonë me qasje krahasuese, dhe sa më shumë e baraspeshuar apo e balancuar në metodologjinë e sajë të veprimit dhe studimit shkencore-politike.

**Modelet në Politikën Krahasuese:** Ndhimojnë në organizimin, ndriçimin dhe dhënien e koherencës për procese, ngjarje apo institucione që mund të shihen si të ndryshme krijojnë mundësinë për kontekste apo mjedise të konceptit të “pyllit” dhe jo vetëm të “pemës” mundësojnë mendimin e qartë për çështje të komplikuar. Mjete heuristike, për mësimdhënie na mësojnë gjëra dhe na mundësojnë shikimin e trendeve. Thjeshtësojnë ngjarje komplekse duke aftësuar kuptimin më të qartë të tyre prej nesh.<sup>17</sup>

<sup>17</sup> Adam Przeworski dhe Henri Teune, *The Logic of Comparative Social Inquiry* (New York: John Wiley, 1970), ff. 26-30.

## Conclusion

Comparative politics began to approach the world around us by analyzing it in the view of development and democratization.<sup>18</sup>

Comparative Policy is one of the most active branch of political science for today. Although characterized by uncertainty about the models and the paradigm in which it walks, constantly refreshes developments in this area with new models and ideas. In the center the study of this field is the governance itself. It in one or another form gives comparative politics water abduction that drives the turbine of comparative political analysis. When we compare and contrast the different patterns of governance we have the opportunity of complaining, learning and formative reflection. Comparison means finding similarities and to contrast it means to stop the changes. A synthesis process of both together brings to us comparative fields of study which in social sciences become mirrors where we look at the advantages and disadvantages of systems and selected political-social and economic regimes. We often and almost inevitably are involved in comparative processes.

We compare ourselves with the others in many aspects; we compare our countries with those of others, etc., etc. Comparisons often leave us a bitter taste and we try to find out causes that brings these kinds of changes. It is through profound comparative study processes that we achieve to find out whether the crow of the other is fatter than our chicken or if the grass is greener in the neighbor's garden. This process goes through very petty strainer when we talk about the comparison process of governments and models of governance. So, when we want to make our own model or when we want to destroy a style of government, a systematic comparative study becomes indispensable. It is important to note that even the best study cannot give us the answers we expect. Politics is a life-filled process and as such it cannot withstand freezing and insertion into formats or models even if they are scientific.

It finds the differences and similarities between states and deals with the processes that explain the differences if they exist. In the field of political science studies there is also what is called field of area study which deals with micro-problems. Here is required detailed and specific

---

<sup>18</sup> Bashkim Selmani, PhD Lecturer at the State University of Tetova, Faculty of Law and exercises the post of Chief of Political Science.



examination of countries such as China, USA, Russia and Southeast Asia, Middle East, Eastern Europe. Switching from macro-problems to micro-problems and in what are known as the middle theories of explanation of the phenomena in comparative politics have occurred in a relatively long process in the last century. It was in the 1960s that the Behavioral Revolution brought radical changes to political science.

This revolution paved the way for the stabilization of macro-theories that passed to the level of middle-ranking theories in the 1980s, a process directly related to technological advancements and expansion of the field of study of comparative politics. Today, we can talk about three major study groups in comparative politics: Industrial Democracies, Post-Socialist or Transitional Countries, Non-Democracies and Developing Countries. The Behaviorist revolution in the 1960s put the importance on theorization at the major level. Research questions which were treated during this period focused on the prerequisite of democracy as a governance system and conditions that demanded democracy in order to become steady and rooted. During this period it was imagined that the democratic model offered by industrialized countries of Western Europe and the United States. So the scientists had in spotlight how to achieve political development.

The move towards middle-scale theorization gave scientific possibilities for explaining development by promoting comparisons between countries in the same specific region. The treatment of countries as a case study and incomparable was overcome by raising awareness in the use of empirical research and comparative methodology. Now, comparative politics did not seek to explain how a whole country functioned but tried to find the particular elements in the political process that could explain policy, focusing on: Voter behavior; Interest groups; and the actions of the political elite. Research Issues who were questioned examined the quality of life issues, the state of social welfare; the new political movements and the lack of stability of political parties. In this way the comparative policy made a great paradigmatic step. It went from studying states as separate and sovereign units to common elements in different countries and regions. Thus comparative politics began approaching the world around us by analyzing it in terms of development and democratization.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> The central idea of these approaches was the creation of a single unified policy of comparative policy that would include various elements of the political process such as public opinion, interest groups, political parties, and political institutions. The aim

## BIBLIOGRAFIA

1. **Alfredson, Gundumur et. Al. 1999.** *The Universal Declaration of Human Rights*. Oslo: Scandinavian University Press.
2. **Bashkim dr.Selmani & Mevledin dr. Mustafi** „Sistemete e sigurisë-Sstema security”-Furkan, ISM-Shkup, 2016.
3. **Alston, Philip and James Crawford (eds.). 2000.** *The Future of UN Human Rights Treaty Monitoring*. Cambridge: Cambridge University Press.
4. **Alston, Philip (ed.). 1999.** *The EU and Human Rights*. Oxford: Oxford University Press.
5. **Andreopoulos, George J. and Richard Pierre Claude. 1997.** *Human Rights Education for Twenty-First Century*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
6. **An-Na'im, Abdullahi Ahmed (ed.). 1992.** *Human Rights Cross-cultural Perspectives, A Quest for Consensus*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
7. **Asia-Europe Foundation (ASEF). 2000.** *The Third Informal ASEM Seminar on Human Rights*. Singapore.
8. **Bankie, B.F., Marias and J. T. Namiseb (comp.). 1998.** *Towards Creating a Sustainable Culture of Human Rights: the Southern African human rights reader*. Windhoek: Macmillan.
9. **Baefsky, Anne F. 2002.** *How to Complain to the UN Human Rights Treaty System*. Transnational Publishers.
10. **Baxi, Upendra. 1994.** *Inhuman Wrong and Human Rights: Unconventional Essays*. Delhi: Har-Anand Publications.
11. **Baxi, Upendra. 2002.** *The Future of Human Rights*. Oxford University Press.
12. **Benedek, Wolfgang (ed.). 1999.** *Human Rights in Bosnia and Herzegovina, Theory and Practice*. The Hague: Martinus Nijoff Publishers.

---

was to explain the links in these political institutions as well as the evolutionary course of political systems in the hope of replicating this model in the developing world. Technological development at the end of the 1980s and the institutionalization of research infrastructures created opportunities for comparative studies outside Europe and the US, which in itself fined the viewpoint of comparative politics.

13. **Benedek, Wolfgang, Esther M. Kissaakye and Gerd Oberleitner (eds.). 2002.** *The Human Rights of Women: International Instruments and African experiences.* London: Zed Books.

14. **Benedek, Wolfgang and Alice Yotopoulos-Marangopoulos (eds.). 2003.** *Anti-Terrorist Measures and Human Rights,* Kulwer Law International (upcoming).